



Australian Government



Çfarë duhet të presësh në ditën e vaksinimit për COVID-19 në entin tuaj rezidencial për kujdes të të moshuarve

Informacione për banorët, familjet, kujdestarët dhe të dashurit

Qeveria australiane ka një strategji për të ofruar vaksina për COVID-19 për të gjithë që jetojnë në Australi.

Punëtorët dhe banorët e moshuar rezidencial do të jenë ndër personat e parë që mund të bëjnë zgjedhjen për të marr vaksinën për COVID-19. Kjo është pjesë e [fazës së parë \(Faza 1a\) e strategjisë e Australiasë për vaksinën për COVID-19](#).

Vaksinimi për COVID-19 për punëtorët dhe banorët e moshuar rezidencial e do të bëhet në objektet e kujdesit për të moshuarit rezidencial. Enti rezidencial për kujdes të të moshuarve do t'ju njoftojë kur do të jetë dita e vaksinimit.

Ky dokument ju jep juve, familjes tuaj, kujdestarëve dhe të dashurve tuaj informacione rreth asaj që mund të prisni deri në ditën tuaj të vaksinimit.

Para ditës së vaksinimit

- Qeveria australiane do të organizojë që vaksinat të dorëzohen në entin tuaj rezidencial për kujdes të të moshuarve.
- Qeveria australiane ka rekrutuar edhe një fuqi punëtore klinike e cila do të vizitojë entin tuaj rezidencial të për kujdes të të moshuarve dhe të administrojë vaksinën për banorët dhe stafin. Këta punëtorë klinik do të punojnë shumë ngushtë me entin deri në ditën e vaksinimit për të planifikuar dhe për t'u siguruar që dita e vaksinimit do të realizohet në mënyrë të sigurtë dhe efikase.
- Enti juaj rezidencial për kujdes të të moshurave do t'ju kërkojë juve dhe vendimmarrësit tuaj zëvendësues (nëse njëri është aty), të pajtoheni për marrjen e vaksinës për COVID-19.
 - Informacionet janë në dispozicion për ju, kështu që ju mund të merrni një vendim të informuar për vaksinimin për COVID-19. Nëse ju nuk jeni pajisur me këto informacione nga entin tuaj, ju mund të gjeni një kopje në faqen e [internetit të Departamentit të Shëndetësisë](#).
 - Para se të jepni pëlqimin, ju, familja juaj, kujdestarët dhe vendimmarrësit gjithashtu mund të zgjidhni të angazhoheni me stafin klinik në entin tuaj, një mjek të përgjithshëm ose profesionistë të tjerë shëndetësorë për të diskutuar përfitimet dhe rreziqet e vaksinimit, dhe nëse është e përshtatshme për ju që të merrni vaksinën për COVID-19.
- Stafi klinik në entin tuaj do të kontrollojë shëndetin tuaj për t'u siguruar se është e përshtatshme për ju që ta merrni vaksinën. Nëse enti juaj ka ndonjë shqetësim në lidhje me shëndetin tuaj ata do të konsultohen me mjekun e përgjithshëm. Ju gjithashtu mund të zgjidhni të bisedoni në çdo kohë me mjekun tuaj të përgjithshëm për shëndetin tuaj dhe vaksinimin për COVID-19.
- Nëse pranoni marrjen e vaksinës për COVID-19, enti juaj rezidencial për kujdes të të moshuarve do t'ju regjistrojë që të merrni vaksinën. Enti juaj do të menaxhojë të gjitha aranzhimet për ditën e vaksinimit me fuqinë punëtore të vaksinimit.
- Vaksina për COVID nuk ka nevojë të përshkruhet për ju nga mjeku juaj i përgjithshëm.
- Ju keni të drejtë të kërkonte avokatin për mbrojtje të të moshuarve nën kujdes. Ky shërbim përmes OPA-s është falas, konfidencial dhe i pavarur nga qeveria dhe ofruesit për kujdes të të moshuarve. Avokatët e të moshuarve nën kujdes në shtetin ose territorin tuaj janë në dispozicion në 1800 700 600 ose në [opan.com.au](#).

Në ditën e vaksinimit

- Nëse keni ndërmend të merrni vaksinën, stafi klinik në entin tuaj do të kontrollojë për t'u siguruar që jeni mirë në ditën e vaksinimit. Nëse keni një problem mjekësor në ditën e vaksinimit, enti juaj rezidencial për kujdes të të moshuarve mund të konsultohet me mjekun e përgjithshëm për të përcaktuar nëse vaksinimi juaj mund të vazhdojë, ose nëse duhet të prolongohet për në një datë tjetër.
- Ju mund të zgjidhni që një person që ju mbështet të vijë në entin tuaj rezidencial për kujdes të të moshuarve në ditën e vaksinimit për t'ju ndihmuar dhe përkrahur. Kjo mund të përfshijë dikë që të përkthejë informacionet ose të sigurojë siguri nëse ndiheni të shqetësuar.
- Ashtu si me çdo vaksinë, mund të keni disa efekte anësore pas marrjes së vaksinës për COVID-19. Informacione rreth asaj se çfarë duhet të prisni pas vaksinimit tuaj do t'ju jepet nga punonjësi klinik që administron vaksinën tuaj. Këto informacione gjithashtu janë në dispozicion në faqen e [internetit të Departamentit të Shëndetësisë](#).
- Pas vaksinimit tuaj, stafi në entin tuaj rezidencial për kujdes të të moshuarve do t'ju monitorojë nga afër. Nëse ndjeheni keq pas marrjes së vaksinës sigurohuni që t'i njoftoni ata.

Qëndroni të përditësuar me informacione të besueshme

Ju mund të gjeni më shumë informacione, duke përfshirë informacionet e përkthyer në Departamentin e Shëndetësisë Faqja e [internetit e vaksinave për COVID-19](#). Ju gjithashtu mund të abonoheni për të marrë [përditësime për vaksinat për COVID-19](#).

Gjithashtu mund të telefononi edhe Linjën Kombëtare për Koronavirus në 1800 020 080, dhe të kërkonti një përkthyes nëse është e nevojshme.

[Rrjeti i Avokimit për Personat e Moshuar \(OPAN\)](#) është në dispozicion nëse dëshironi të flisni për ndonjë çështje ose shqetësim që keni në lidhje me COVID-19 ose nëse keni nevojë për ndihmë që ka të bëjë me ofruesin tuaj për kujdes të të moshuarve. Telefononi 1800 237 981, 6am-10pm (AEDT), 7 ditë në javë ose dërgoni mail në covid@opan.com.au.